



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-108

Prishtinë, më 29 prill 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 29 PRILL 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi - kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Jasmina Zhivković dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtura më 21 dhe 22 prill 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 21 dhe 22 prill 2013

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 21 dhe 22 prill 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave të mbajë tri seanca dhe atë:

Seanca solemne më 30 prill 2013, në orën 12:00, me këtë:

R e n d d i t e

1. Shënimi i 14 Vjetorit të rënies së Heroit-Gjeneralit Ilaz Kodra dhe të gjithë dëshmorëve të Brigadës 114 të UÇK-së, “Fehmi Ladrovci”.

Mbledhja plenare më 2 maj 2013, në orën 10:00, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Miratimi i Marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera

joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete,

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatinë,
7. Interpelanca e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Ramë Buja, sipas kërkesë së deputetit Burim Ramadani, mbështetur edhe nga 7 deputetë tjerë lidhur me çështjen e arsimit në Kosovë,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012,
10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,
11. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor,
12. Emërimi i dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryesia po ashtu vendosi që më 2 maj 2013, në orën 12:00 të mbahet seancë solemne, në të cilën z. Ekmeleddin Ihsanoglu, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës për Bashkëpunim Islamik, do t'iu drejtohet me një fjalë rasti deputetëve të Kuvendit.

Seanca solemne më 10 maj në orën 12:00, me këtë:

R e n d d i t e

1. Shënimi i 15-Vjetorit të Betejës së Llapushnikut.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për debat parlamentar lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, vendosi që Debatin parlamentar për gjendjen e pyjeve në Kosovë, të radhitet në rend dite për mbledhjen tjetër të radhës.

2. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar për mbështetje financiare, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar për lejimin e mjeteve buxhetore dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për delegacionin e Nën-Komisionit për Partneritet me NATO-n, që do ta vizitojë Kosovën, prej 28 deri më 30 maj 2013

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për një drekë dhe darkë, transporti i brendshëm sipas agjendës, si dhe shpenzimet tjera që dalin gjatë qëndrimit të delegacionit të Nën-Komisionit për Partneritet me NATO-n i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, me rastin e vizitës në Kosovë, prej datës 28-30 Maj 2013.

4. Propozimi për lejimin e heqjes së aseteve (automjeteve) të amortizuara të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, kërkoi nga Administrata e Kuvendit që të bëjë specifikim e hollësisht të automjeteve që duhet hequr, si dhe të veprojë në përputhje me Ligjin nr. 02-2643-1/06 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Rregulloren për përdorimin e automjeteve të Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale